

**VENDIM**  
**Nr. 103, datë 9.5.2022**

**MBI SHTYRJEN E VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-s, LIDHUR ME KËRKESËN E SHOQËRISË “HERA” SHPK, PËR TRANSFERIMIN E PLOTË TË LICENCËS NR. 49, SERIA NPM07P, DHËNË ME VENDIMIN E BORDIT NR. 61, DATË 2.11.2007, “PËR NDËRTIMIN, INSTALIMIN, SHFRYTËZIMIN DHE PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALE ME ERË (PROJEKTI KAPPET)”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 67, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2017; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 9.5.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes me nr. 608/4 prot., datë 5.5.2022, “Mbi shtyrjen e afatit të vendimarrjes së Bordit të ERE-s, lidhur me kërkesën e shoqërisë ‘HERA’ sh.p.k., për transferimin e plotë të licencës nr. 49, seria NPM07P, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 61, datë 2.11.2007, të ndryshuar, ‘Për ndërtimin, instalimin, shfrytëzimin dhe prodhimin e energjisë elektrike nga centrale me erë (projekti KAPPET)’, të ndryshuar”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 48, datë 23.3.2022, vendosi të shtyjë me 30 ditë pune vendimarrjen e tij përfundimtare për kërkesën e shoqërisë “HERA” sh.p.k. për transferimin e plotë të licencës, për të marrë kohën e mjaftueshme për të shqyrtuar dokumentacionin e depozituar me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 65/5 prot., datë 18.3.2022, nr. 65/6 prot., datë 18.3.2022 dhe nr. 65/7 prot., datë 18.3.2022, të shoqërive “HERA” sh.p.k. dhe “SOT-AL” sh.p.k., të cilat kanë depozituar dokumentacion shtesë në lidhje me transferimin e licencës.

- Afati 30-ditor për t’u shprehur ERE përmbushet në datën 9.5.2022, por duke qenë se nga shqyrtimi i shkresave të përcjella nga shoqëritë “HERA” sh.p.k. dhe “SOT-AL” sh.p.k. (të cilat kanë depozituar dokumentacion shtesë në lidhje me transferimin e licencës), lind nevoja për të sqaruar më tej çështjet që kanë të bëjnë me rregullimin e pronësisë, si dhe financimin e projektit KAPPET, vlerësohet zhvillimi i një seance dëgjimore dhe si rrjedhojë zgjatja me 30 ditë pune nga marrja e njoftimit të këtij vendimi të afatit të vendimarrjes së Bordit të ERE-s, në lidhje me kërkesën e shoqërisë “HERA” sh.p.k., për transferimin e plotë të licencës së prodhimit të energjisë elektrike.

- Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

**VENDOSI:**

1. Të shtyjë me 30 (tridhjetë) ditë pune nga marrja e njoftimit të këtij vendimi, vendimarrjen përfundimtare të Bordit të ERE-s, në lidhje me kërkesën e shoqërisë “HERA” sh.p.k. nr. 49, seria NPM07P, dhënë me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 61, datë 2.11.2007, “Për ndërtimin, instalimin, shfrytëzimin dhe prodhimin e energjisë elektrike nga centrale me erë (projekti KAPPET)”, të ndryshuar, për plotësimin e dokumentacionit të munguar mbi kërkesën për transferimin e licencës të shoqëria “SOT-AL” sh.p.k.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR**  
**Petrit Ahmeti**